

REPUBLIKA E KOSOVËS
 Komuna e Prizrenit
 Kryetari i Komunës
 Nr. 01/011-18108
 Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Nënkyetarit të Komunës, për mbështetje financiare për organizimin e takimit me përfaqësuesit e KFOR-it gjerman, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
 PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Nënkyetarit të Komunës, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e takimeve zyrtare ndërmjet përfaqësuesve të Komunës së Prizrenit me përfaqësuesit e KFOR-it gjerman, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të organizimit të këtyre takimeve, lejohen mjetet në shumën prej 900 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:

- a. Nga pozicionet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit lejohen 300 €,
- b. Nga pozicionet e Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencës lejohen 300 €, dhe
- c. Nga pozicionet e Drejtorisë së Shëndetësisë lejohen 300 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Nënkyetari i Komunës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
 Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18111
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 2 pacientëve, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 22.8.2013, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve:

1. Hysen Maralusha dhe
2. Safete Kryeziu.

Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18115
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, për Shpresa Osmanollajn, shërbyese civile në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, për Shpresa Osmanollajn, shërbyese civile në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor), lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:

- a. Nga pozicionet e Drejtorisë së Shëndetësisë lejohen..... 500 €,
- b. Nga pozicionet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike lejohen.... 1000 €, dhe
- c. Nga pozicionet e Drejtorisë së Administratës lejohen.....500 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18119
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për shënimin e manifestimit “Dita e Rinisë”, kryetari i Komunës, më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 20.8.2013, për përkrahje financiare për shënimin dhe organizimin e manifestimit “Dita e Rinisë”, i cili manifestim organizohet në bashkëpunim me Departamentin e Rinisë të Komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Kulturës, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2500 €.

Bartës të projektit do të jenë: Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Qendra Rinore, Këshilli i nxënësve të shkollave të mesme, OJQ-të rinore, etj.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18125
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për formimin e Grupit Punues për përgatitjen e projektit të programit për banim në komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës, me 27 gusht 2013, mori këtë

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për përgatitjen e projektit të programit për banim në komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

- a. Fatmir Pireci, nga DPMS,
- b. Ylber Gashi, nga DUPH, dhe
- c. Islam Osmankaj, nga DEF.

II. Detyrat e Grupit Punues nga pika I e këtij Aktvendimi janë të përshkruara në Vendimin e kryetarit të komunës nr. 01/011-18155

III. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të emëruarit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18129
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejin e mjeteve financiare për pagesë të shpenzimeve të varrimit për invalidin e luftës Burim Shala dhe veteranit të luftës Mursel Osmanit, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 20.8.2013, për lejin e mjeteve financiare për pagesë të shpenzimeve të varrimit të invalidit të luftës Burim Shala dhe veteranit të luftës Mursel Osmanit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të pagesës së faturës së KRM "Ekoregjioni" në Prizren, lejohet mjetet financiare në shumën 426 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, KRM "Ekoregjioni" në Prizren, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18131
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Gjermani dhe pagesës së mëditjeve për Kumrije Bytyqin dhe Vehibe Karahoda, kryetari i Komunës, më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Kumrije Bytyqit dhe Vehibe Karahodës, zyrtare komunale në QPS, për në Dresden të Republikës së Gjermanisë, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimet me temën: “Programi për Mbrojtjen Sociale dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë”. Trajnimi do të mbahen nga data 8 shtator deri me 14 shtator 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurat.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurat, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18136
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, për Slobodanka Kuçani, shërbyese civile në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, për Slobodanka Kuçanin, shërbyese civile në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit (operimit të syve), lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 900 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me uniforma verore dhe dimërore për zjarrfikës, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 21.8.2013 për lejimin e furnizimit me uniforma verore dhe dimërore për zjarrfikës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18144
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejin e mjeteve financiare për sigurimin e ushqimit për zjarrfikësit, të cilët janë të angazhuar në shuarjen e zjarreve, kryetari i Komunës, më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejin e mjeteve financiare për sigurimin e ushqimit (shujtës) për zjarrfikësit, të cilët janë angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë periudhës së verës në Komunën e Prizrenit. Kështu që, lejohen mjetet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës) për zjarrfikësit e lartcekur.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencione dhe mallrave dhe shërbime të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë dhe drejtorive të tjera.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për izolimin me grila të hekurit të zyre të Gjendjes Civile, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N


Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 30.7.2013 për lejimin e izolimit me grila të hekurit të disa zyrave të Gjendjes Civile, (furnizim me grila, ngjyrë, material për saldim), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

The image shows an official circular stamp of the Municipality of Prizren, Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVËS", "KOMUNA E PRIZRENIT", "Kryetari i Komunës", and "Prof. dr. Ramadan Muja". A handwritten signature in black ink is written over the stamp.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2013 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për ndryshimin dhe plotësimin e Aktvendimit nr. 01/011-4721, të datës 10.4.2013, mori këtë:

KONKLUZION

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa për ndryshimin dhe plotësimin e Aktvendimit nr. 01/011-4721, të datës 10.4.2013, që ka të bëjë me lejimin e mjeteve për pagesën e punëve dhe shërbimeve të veçanta për Komunën e Prizrenit, dhe duhet të jetë si në vijim:

II. Miratohet propozimi i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, për lejimin e kryerjes së punëve dhe shërbimeve të veçanta për nevojat e Komunës së Prizrenit (për angazhim të ekspertëve të jashtëm në dhënien e këshillave profesionalë për ngritjen e të hyrave vetjake në Komunën e Prizrenit, etj.), dhe për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës. Për realizimin e këtij konkluzioni do të kujdeset Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Kamadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 27.8.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Ekonomisë dhe Financave për miratimin e Draftregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet Komunale, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet Draftregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet Komunale nr. 01/011-4099, të datës 18 qershor 2009, i propozuar nga Drejtoria për Ekonomisë dhe Financave.

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, KPF-ja, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejjimin e rekrutimit të disa nëpunësve për kryerje të shërbimeve të veçanta në Komunën e Prizrenit për kohë të caktuar, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejjimin e rekrutimit të 4 punëtorëve për kryerje të shërbimeve të veçanta për nevojat e Komunës së Prizrenit (Njësinë Pyjore në Prizren) për kohë të caktuar, kështu që, lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për rekrutimin e 4 punëtorëve për kryerjen e shërbimeve të lartcekura.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Personelit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18147
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për Organizatën e Veteranëve të Luftës të UÇK-së, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për Organizatën e Veteranëve të Luftës të UÇK-së lidhur me realizimin e projektit që ka të bëjë me dërgimin e anëtarëve të kësaj Organizate në pushime verore (rekreacion), kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të lartcekura, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:

- a. Nga pozicionet e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lejohen 500 €,
- b. Nga pozicionet e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave lejohen 500 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OVL të UÇK-së, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-zyrtar
Më 27.8.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 27.8.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për inicimin e procedurës për ndërrimin e ngastrës kadastrore nr. 7326-1 e dhënë në shfrytëzim Zeqir Hoxhës nga Kuvendi i Komunës, me ngastrën kadastrore nr. 5260-2, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për inicimin e procedurës për ndërrimin e ngastrës kadastrore nr. 7326-1, në sipërfaqe prej 2.75 ari, e dhënë në shfrytëzim Zeqir Hoxhës nga Kuvendi i Komunës, me ngastrën kadastrore nr. 5260-2, me sipërfaqe prej 2.75 ari në vendin “Dardania 2”.

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t’ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, KPF-ja, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18150
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e mjeteve financiare për furnizimit me pjesë për montim të hidroforit në shtëpinë e Javoroka Nedelkoviç në fshatin Smaq, kryetari i Komunës më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim për lejimin e mjeteve financiare për furnizimit me pjesë për montim të hidroforit në shtëpinë e Javoroka Nedelkoviçit në fshatin Smaq, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 100 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18153
Më 27.8.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, rreth lejitimit të mjeteve financiare për pagesën e shpenzimeve të drekës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaqi me mësimdhënësit e Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, më 27 gusht 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejitimin e mjeteve financiare për pagesën e shpenzimeve të drekës së kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaqi me mësimdhënësit e Komunës së Prizrenit, që do të mbahet në DPH "Villa Park" me datën 2.9.2013, kështu që për këtë qëllim, dhe në emër të shpenzimeve të lartcekura, lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Beledyesi

Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-18155
Më 27.8.2013

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L040 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008 , nenit 25 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit nr. 03//L-164 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 67 e datës 29/03/2010 dhe neneve 50 dhe 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 i datës 15 tetor 2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë :

V E N D I M

PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT PËR BANIM TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUdhËN 2013-2015

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i përgatitjes së Projektit të Programit për banim të Komunës së Prizrenit për periudhën 2013-2015 (në vazhdim të tekstit) është që ti propozohet Kuvendit të Komunës miratimi i tij me qëllim të krijimit të kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike ti përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe të bëhet caktimi i mënyrës dhe sigurimi i shfrytëzimit të mjeteve financiare për këtë qëllim.

Neni 2 **Obligimi i organeve për përgatitjen e Projektit**

2.1. Bartës kryesor për përgatitjen e këtij Projekti caktohet Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale , Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa , të cilët do të bëjnë përgatitjen e Projektit në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit , Udhëzimeve Administrative të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Qeverisë së Republikës së Kosovës . Udhëzimit Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira dhe joprofitabile nr. 18/2010 si dhe Udhëzimit për përmbajtjen e Bonusit të Banimit nr. 19/2010.

2.2. Drejtoritë nga paragrafi paraparak gjatë përgatitjes së Projektit do të bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me Drejtoritë tjera të Administratës së Komunës në çështjet sipas kompetencës .

Neni 3

Përmbajtja e Projektit të Programit

3.1 Programi duhet të rregullojë çështjet në pajtim me dispozitat e cekura ligjore

3.2 Projekti i Programit duhet të rregullojë posaçërisht këto çështje :

- Kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë sipas Programeve të veçanta të banimit ;
- Banesat në pronësi të Komunës të cilat ipen me qira duke përfshirë mënyrën e shfrytëzimit të banesave , administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave , caktimin e qirasë , subvencionimin e qirasë , përparësitë në përzgjedhjen e përfituesve , verifikimin e gjendjes ekonomike të familjeve , si dhe çështjet lidhur me kontratat mbi qiranë;
- Procedurat në pajtim me ligjin përkitazi me bonuset e banimit si dhe
- Planifikimi i burimeve financiare për financimin e Programit sipas kriterëve të përcaktuara me nenin 21 të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit .

Neni 4

Afati për përfundimin e Projektit

Projekti duhet të përgatitet për miratim nga Kuvendi i Komunës më së largu deri më 01/10/2013 në mënyrë që miratimi i Programit dhe shumat e planifikuara financiare , të planifikohen me kohë edhe në Projektin e Buxhetit të Komunës për 2014.

Neni 5

Njoftimi

Me këtë Vendim të njoftohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor . Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal , Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa .

Neni 6

Publikimi dhe hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja